

**VENDIM**  
Nr.1181, datë 23.7.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME  
KONCESION VENDOR TË PARKIMIT NËNTOKËSOR, NË PARKUN "RINIA", TIRANË,  
DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE,  
QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja "b" të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006, "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion vendor të parkimit nëntokësor në parkun "Rinia", Tiranë, është Bashkia e Tiranës.
2. Miratimin e bonusit prej 1 për qind të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "Taiwan", sh.p.k.
3. Ngarkohet Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
Sali Berisha